



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtina, më 21 qershor 2010
Nr. ref.: URDH.27 /10

URDHËR

Rasti nr. KO 01/09

Qemaji Kurtishit

dhe

Kuvendit Komunal të Prizrenit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjykata Kushtetuese e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Hyrje

1. Gjykata Kushtetuese thirret në Aktgjykimin e Gjykatës, të 18 marsit 2010, lidhur me kërkesën e mësipërme. Në Aktgjykimin e vet, Gjykata, ndër të tjera:
 - Urdhëroi komunën e Prizrenit që, brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i këtij Aktgjykimi, ta ndryshonte Statutin dhe emblemën e saj, në mënyrë që ta sillte atë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të mos i përjashtojë komunitetet jo-shumicë;
 - Kërkoi nga komuna e Prizrenit, t'i raportonte Gjykatës mbi përparimin në lidhje me pajtueshmërinë me atë Urdhër, para skadimit të periudhës prej tre muajve prej dorëzimit të këtij Aktgjykimi; dhe
 - Mbetet e angazhuar fuqimisht për çështjen, në pritje të pajtueshmërisë me atë Urdhër.

Korrespondenca nga komuna e Prizrenit

2. Në mbështetje të Aktgjykimit, kryetari i komunës së Prizrenit, Dr. Ramadan Muja, iu drejtua me një letër Gjykatës Kushtetuese më 17 qershor 2010. Në atë letër, kryetari pranon që komuna e Prizrenit, si zbatuese e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, ishte në dijeni se Aktgjykimi i Gjykatës ishte i formës së prerë. Kryetari e njoftoi Gjykatën se komuna e Prizrenit kishte ndërmarrë masa përgatitore për zbatimin e këtij Aktgjykimi. Ai më tej theksoi që komunës i duhej një periudhë shtesë prej 60 ditësh, për ta përfunduar përmbarimin dhe për t'i mundësuar asaj të veprojë në përputhje me Urdhrin e Gjykatës.
3. Gjykata sjell ndër mend me sa vijon:
 - i. komuna pranoi përgjegjësinë e vet, në letrën e dërguar më 17 qershor 2010, për t'u pajtuar me Aktgjykimin e Gjykatës;
 - ii. përpjekjet që i janë raportuar gjykatës për të siguruar pajtim, dhe
 - iii. arsyeshmërinë e kërkesës dhe kufizimet kohore që komuna mund t'i hasë gjatë muajve të ardhshëm.

VENDIM

Gjykata, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje më 18 qershor 2010, njëzëri

VENDOS

- I. Ta vazhdojë afatin kohor të caktuar nga Gjykata në Aktgjykimin e vet të 18 marsit 2010, për një periudhë tremujore nga ajo datë;
- II. Kërkon nga komuna e Prizrenit, t'i raportojë përsëri Gjykatës mbi përparimin në lidhje me pajtueshmërinë me atë Urdhër, para skadimit të periudhës së tre muajve, prej dorëzimit të këtij Aktgjykimi;
- III. Mbetet e angazhuar fuqimisht për çështjen në pritje të pajtueshmërisë me atë Urdhër; dhe
- IV. Ky Vendim do t'i komunikohet komunës së Prizrenit dhe parashtruesit të kërkesës, dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi më 18 qershor 2010.

Gjyqtari raportues

Gjyqtari Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës

Prof. Dr. Enver Hasani

